

V E N D I M
Nr. 554, datë 7.11.2002

**PËR NJË SHITESË NË RREGULLOREN "PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE
USHQIMORE", TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 604, DATË 17.11.2000 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr. 7941, datë 31.5.1995 "Për ushqimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pas shkronjës "b", në pikën 8.2 "Gjuha" të rregullores "Për etiketimin e produkteve ushqimore", të miratuar me vendimin nr. 604, datë 17.11.2000 të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c. Për produktet ushqimore të importuara, të dhënat për emërtimin e produktit, karakteristikat e tij, (natyrën, vetitë, përbërjen etj.), mënyrën e përdorimit, kushtet e ruajtjes, datën e fundit të përdorimit, si dhe emrin dhe adresën e importuesit, duhet të jepen në gjuhën shqipe, në etiketën origjinale ose të vendosen në një etiketë tjetër, së bashku me etiketën origjinale."

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me 1 janar 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano